

## AKT - THEMELIMI I SHOQËRISË TREGTARE

### “EMCON GROUP” SH.P.K

Sot, më datë 01/11/2024 , Unë i nënshkruari,

Erfan Xhelili, i datëlindjes 15.02.1985 lindur në Sarandë, Kopaçez, dhe banues në Tiranë madhor, me zotësi të plotë juridike dhe zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit me nr.personal 034021484

bazuar ne Ligjin Nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” *vendosa* të themeloj shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar me emërtimin “EMCON GROUP” SHPK, sipas parashikimeve te mëposhtme:

#### NENI 1

##### Emri i shoqërisë

Emërtimi i Plotë i Shoqërisë Tregtare është “EMCON GROUP” SH.P.K.

#### NENI 2

##### Selia e shoqërisë

Selia e shoqërisë ndodhet në Tiranë në adresën: Rruga “Ferit Xhajko”, Hyrje 1, Njësia Bashkiake Administrative Nr. 8, Nr, 1017, Tiranë  
Shoqëria mund të zhvillojë aktivitetin e saj brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë nëpërmjet hapjes së degëve dhe zyrave të përfaqësimit. Hapja e degëve dhe zyrave të përfaqësimit bëhet sipas parashikimeve të nenit 9 të Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.


#### NENI 3

##### Objekti i veprimtarisë

Shoqëria do të ketë si objekt të veprimtarisë së saj:

Shoqëria do të ketë si objekt të veprimtarisë së saj:

- Kryerjen e veprimtarisë në fushën e ndërtimit, duke kryer punime dheu, punime inxhinierike per rrjetin e ujesjelles-kanalizimit te jashtme dhe te brendshme,punime shtresash e izolime, sistemime, taracime terrenesh, punime rifiniture e muresh, murature betoni, beton arme te zakonshme dhe speciale nje dhe shumekateshe, punime shembjesh, blerje dhe shitje materiale ndërtimi,



- ndërtime civile, industriale, turistike, bujqësore, punime restaurimi, mirëmbajtje e punime shërbimi të zakonshme të sistemit komunal etj,
- tregtimin e lendeve të para ndërtimore, import, eksport, tregti me shumice e pakicë të materialeve të ndryshme ndërtimore etj,
  - Mbikqyrje të ndërtimit të pasurive të paluajtshme civile, industriale, ushtarake, banesa, hotele, objekte kulti, rruge, infrastrukture etj.
  - Cdo veprimtari tjetër tregtare të lejuar nga legjislacioni shqiptar që lidhet drejtpërdrejt ose indirekt me veprimtaritë e sipërcituara

#### **NENI 4** **Kapitali i Shoqërisë**

Kapitali i regjistruar i shoqërisë është 100,000 (njëqind mijë) lekë. Pjesëmarja e ortakut themelues në kapitalin e shoqërisë është si më poshtë:

**Ortaku themelues z. Erfan Xhelili** zotërues i 1 kuote me vlerë 100,000 lekë, i cili zotëron 100 % të kapitalit themeltar të shoqërisë;

Kapitali themeltar do të shlyhet nga ortakut themelues në llogarinet bankare të Shoqërisë, pas regjistrimit të saj në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

#### **NENI 5** **Kohëzgjatja e shoqërisë**

Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj për një afat kohor të pacaktuar. Afati i aktivitetit fillon mbas regjistrimit të Shoqërisë në Regjistrin Tregtar dhe mund të zgjatet ose shkurtohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

#### **NENI 6** **Organet Drejtuese**

Në zbatim të Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", organet drejtuese të Shoqërisë janë si më poshtë vijon :

1. Asambleja e Përgjithshme – organi më i lartë vendimmarrës;
2. Administratori – organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqërisë;

Mënyra e organizimit dhe funksionimit të këtyre organeve rregullohet dhe ushtrohet sipas parashikimeve të Statutit të Shoqërisë dhe legjislacionit në fuqi.

Shoqëria do të përfaqësohet ligjërisht nga Administratori i saj i cili është z.Erfan Xhelili, i datëlindjes 15.02.1985 lindur në Sarandë, Kopaçez, dhe banues në Tiranë madhor, me



zotësi të plotë juridike dhe zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit me nr.personal 034021484

**NENI 7**  
**Dispozitat përfundimtare**

Akt Themelimi hartohet në 4 (katër) kopje të njëjta në gjuhën shqipe.  
Ngarkohet Administratori i Shoqërisë që të kryejë procedurat e Regjistrimit të Shoqërisë në Qendrën Kombetare të Biznesit. Këtë detyrim, Administratori mund ta kryejë personalisht, ose përmes personave të caktuar prej tij me Autorizim ose Prokurë të Posaçme.

**Ortaku Themelues**  
**Erfan XHELILI**

